



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:004395

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505508

Ac.nr.2380/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve I.B., H.B., K.B., I.B., E.B., M.B., A.B., N.B. të gjithë nga fshati K....., Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar Avokati Qazim Qeska nga R.....i, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor B.O., për vërtetim pronësie, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditurës e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, C.nr.561/2019, i datës 20.01.2021, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Komuna e Rahovecit, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, C.nr.561/2019, i datës 20.01.2021 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.561/2019 të datës 20.01.2015, ka vendosur si në vijim:

APROVOHET kërkesëpadia e paditësve, **SI E BAZUAR.**

VËRTETOHET SE paditësit I.B., H.B., K.B., I.B., E.B., M.B., A.B. dhe N.B., janë bashkëpronar me **1/8-tën** pjesë, të paluajtshmërisë të parcelës kadastrale nr. **491-0**, në vendin e quajtur “Lluga”, në sipërfaqe prej **319 m²**, ZK K....., e cila kufizohet në lindje me parcelën nr.495-1, 495-4, 495-6 në gjatësi prej 27.41 m + 4.00 m + 22.43 m =53.84 m, në jug me parcelën amë nr.491-0, në gjatësi prej 4.88m, në perëndim me parcelën nr. 485-5, 485-4, 485-3 në gjatësi prej 22.65 m + 5.00 + 27.53 m =55.18 m, në veri me parcelën amë nr.491-0 në gjatësi prej 6.94 m, në bazë të parashkrimit fitues, çka e **paditura** është e **obliguar** që të

pranojë këtë të drejtë dhe të lejojë që paditësi të regjistrohet si pronarë në regjistrin Kadastral të Pronave pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në R....., ku si bazë juridike do të shërbejë ky aktgjykim dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin të përmbarrimit të detyrueshëm.

Detyrohet e paditura që paditësve ti paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 545.00 Euro, po ashtu në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës konestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që i njëjti të ndryshohet në atë mënyrë që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazë ose të priset dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

I autorizuari I paditësve me përgjigje në ankesë i ka propozuar Gjykatës së Apelit, që ankesën e palës së paditur ta refuzoj si të pabazë ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetoj si të drejtë dhe me bazë ligjore.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit: I.B., H.B., K.B., I.B., E.B., M.B., A.B. dhe N.B., përmes të autorizuarit të tij, me datë 21.09.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, të cilën e ka precizuar si në parashtresën të datës 29.01.2021, me të cilën ka kërkuar që të:

VËRTETOHET SE paditësit I.B., H.B., K.B., I.B., E.B., M.B., A.B. dhe N.B., janë bashkëpronar me 1/8-tën pjesë, të paluajtshmërisë të parcelës kadastrale nr. 491-0, në vendin e quajtur "Lluga", në sipërfaqe prej 319 m², ZK K....., e cila kufizohet në lindje me parcelën nr.495-1, 495-4, 495-6 në gjatësi prej 27.41 m + 4.00 m + 22.43 m =53.84 m, në jug me parcelën amë nr.491-0, në gjatësi prej 4.88m, në perëndim me parcelën nr. 485-5, 485-4, 485-3 në gjatësi prej 22.65 m + 5.00 + 27.53 m =55.18 m, në veri me parcelën amë nr.491-0 në gjatësi prej 6.94 m, në bazë të parashkrimit fitues, çka e paditura është e obliguar që të pranojë këtë të drejtë dhe të lejojë që paditësi të regjistrohet si pronarë në regjistrin Kadastral të Pronave pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në R....., ku si bazë juridike do të shërbejë ky aktgjykim dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin të përmbarrimit të detyrueshëm. Detyrohet e paditura që paditësve ti paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 545.00 Euro, po ashtu në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, C.nr.561/2019, me aktvendimin C.nr.333/2018 të datës 04.04.2019, ka vendosur që: Në këtë çështje juridike ndërprehet procedura. Nga një kopje e aktvendimit si dhe shkresat e tjera të lëndës ti dërgohen Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Ekonomi dhe Financa në Prishtinë. Procedura do të vazhdoj pas skadimit të afatit prej 180 ditëve.

Paditësit përmes të autorizuarit të tij, me parashtresën e datës 10.12.2019, ka propozuar që të: Vazhdohet procedura në këtë lëndë kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, ka caktuar seancat e shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.561/2019, i datës 20.01.2021, me të cilin e ka aprovuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Me shikimin në certifikatën e pronës të lëshuar me datë 26.10.2020, vërtetohet se parcela nr. 491-0, në sipërfaqe prej 1135 m², ZK K....., evidentohen në emër të Pronë Shoqërore Rrugët KK R.....Me shikimin në historianit e datës 11.08.2018 së bashku me skicën e terrenit, vërtetohet se sipas gjendjes së fundit në elaboratin kadastral në R....., parcela kadastrale nr.56-0 në vendin e quajtur “Llukare” me kulturë shterp, në sipërfaqe prej 0.11,35 ZK K....., evidentohet në emër të Pronë Shoqërore Rrugët KK R.....Me shikimin në ekspertizën e ekspertit gjeometër A.M. e datës 12.01.2021, vërtetohet se parcela kadastrale nr. 491-0, në vendin e quajtur “Lluka” me kulturë “Rrugë e pakategorizuar”, në sipërfaqe prej 0.11,35 ZK K....., evidentohen në emër të Pronë Shoqërore Rrugët KK R.....Dëshmitari R.Th.ka deklaruar se tani i ka bërë 71 vjet dhe qysh e mban mend me në pjesën ku pretendohet me dokumente se ekziston rruga, kjo rrugë asnjë herë nuk ka qenë në terren, rruga ekzistuese sot e kësaj dite është rruga afër shkollës, pra në pjesën e pronës – pronave ku janë të ndërtuara plot shtëpitë të fshatit nuk ka ekzistuar kurrë rrugë, as për këmbësori, këto të thënat e tija gjykata ka mundur t’i vërtetoj edhe nga vendi i ngjarjes pasi që shihet se nuk ka asnjë shenjë të rrugës. Dëshmitari S.Bka deklaruar se që nga viti 1984 e ka ndërtuar shtëpinë e tij në atë pjesë afër kësaj parcele dhe është kojshi me paditësit dhe që në atë vit me ndihmën një firme që ka hapur rrugët aso kohe ka fituar qasje në parcelën e tij pra siç e keni parë edhe ju në teren ajo pjesë është shpatë dhe deri në atë kohë nuk ka pasur mundësi të kenë qasje në parcelat e tyre, lidhur me atë se në dokumente ekziston një rrugë si fëmijë mund të thotë se kurrë nuk ka ekzistuar rruga në atë pjesë.

Tutje gjykata ka shtuar se gjatë vendosjes në këtë çështje juridike, gjykata është mbështetë në dispozitat e Ligjit Themelor mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike (Gazete Zyrtare e RFSJ-së nr.6) i cili Ligj ka qenë në fuqi. Sipas dispozitës së nenit 21 të LTHMPJ-së, është paraparë se “sipas vetë ligjit e drejta e pronësisë fitohet në mes tjerash edhe mbajtjen të parashkrimit fitues”. Neni 28 al.2 po këtij ligji në mënyrë decisive parasheh se “mbajtësi me mirëbesim dhe të ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri e ka të drejtën e pronësisë, e fiton të drejtën e pronësisë, mbi atë send me parashkrim fitues, me kalimin e kohës prej 10 vite”, ndërsa neni 28 al.4 parasheh se “ mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë e fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrim fitues me kalimin e kohës prej 20 vitesh. Sipas dispozitës të nenit 29 me të cilën është kufizuar se sendet që janë në pronësi shoqërore, e drejta e pronësisë nuk ka mundur të fitohet me mbajtje, tani neni 29 është shlyer dhe nga data 04.07.1996, kur është hyrë në fuqi, ndryshim i këtij ligji kanë kaluar mbi 20 vjet, kështu që tani lejohet fitimi i pronësisë edhe në pasuri shoqërore me mbajtje me mirëbesim. Neni 30 të këtij ligji parasheh se koha e nevojshme për parashkrim fitues fillon të ecë nga ajo ditë kur paditësi ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme me parashkrim fitues”. Mes tjerash edhe me Ligjin e ri për Pronësi dhe të Drejtat tjera Sendore nr.03/L-154 përkatësisht neni 40 të këtij ligji parashihet se personi i cili me mirëbesim e ka mbi 20 vite në posedim e ka patundshmërinë ose pjesën e saj e fiton pronësinë në të. Gjykata në këtë çështje juridike si fakt relevant merr nga se në këtë çështje juridike për fitimin e të drejtës të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues paraqet fakti periudha prej kur paditësi e ka pasur në posedim dhe mbajtje mbi 20 vite, e cila periudhë është e mjaftueshme për fitimin e të drejtës së pronësisë në bazë të mbajtjes me parashkrim fitues. Kurse si fakt irrelevant është mbrojtja e të paditurës se patundshmëria

evidentohet në emër të paditurës, sipas të gjitha dispozitave ligjore evidenca nuk është e vetmja dëshmi as për humbjen e as për fitimin e pronësisë.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ju ka referuar neneve 28 paragraf 4, 40.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (LMTHJP). Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejt dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) dhe k), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 pika 4 dhe 5 të LPK-së. Gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe gjerë tek zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë, po ashtu gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejt dhe të plotë gjendjen faktike, rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve sipas pretendimeve nga padia, për arsye se gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetojë faktet me rëndësi për të vendosur sipas padisë së paditësve dhe atë: se paditësit kanë pasur në posedim parcelën kadastrale ndonjëherë apo posedimin e ka pasur e paditura, se posedimi a ishte me mirëbesim dhe i pa ndërprerë, duke e llogaritur edhe kohën e mbajtjes në posedim nga paraardhësi juridik i tyre e deri në paraqitjen e padisë në gjykatë, se ky posedim a është kontestuar nga palët, paraardhësit juridik të tyre apo pretendim i ndonjë pale të tretë, nuk është vërtetuar fakti se parcela kontestuese kur dhe në çfarë bazë është regjistruar në emër të paditurës, gjykata edhe pse ka dal në vendshikim për të bërë identifikimin e saktë të parcelës kadastrale-kontestuese, në të cilën paditësit kanë pretenduar se kanë të drejtën e pronësisë, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësit, ta konstatoi saktë gjendjen faktike-gjegjësisht nuk ka konstatuar se objekt kontesti është parcela kontestuese apo një pjesë e saj, cila është shtrirja gjeografike e saj, gjatësia dhe gjerësia, sa është sipërfaqja e saktë e pjesës së paluajtshmërisë kontestuese, nuk ka konstatuar se parcela kontestuese në posedimin e kujt gjendet në momentin e shikimit në vend, kush aktualisht e ka në posedim, ekspertiza e ekspertit gjeodet është e paqartë, e mangët dhe kontradiktore në vetvete, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes nuk ka konstatuar

gjendjen faktike në vend, nuk ka kërkuar historiatin e pronës se në çfarë baze juridike e paditura është e evidentuar si pronare e paluajtshmerisë kontestuese, nuk ka kërkuar korigjimin dhe plotësimin e ekspertizës së ekspertit gjeodet sepse nëse i referohemi të njëjtës nga e njëjta rezulton se ka vetëm përshkrim të historiatit të pronës e jo të dhëna të sakta për parcelën kadastrale kontestuese si: nuk ka përshkrim të gjendjes faktike në vend - nuk ka të dhëna se objekt kontesti është parcela kontestuese apo pjesa e saj, nuk ka konstatuar se parcela kontestuese në momentin e shikimit në vend çfarë kulture ka detaisht, cila është shtrirja gjeografike e saj, me cilat parcela fqinje kufizohet etj., nuk ka dëgjuar palët në cilësi të palës, nuk ka dëgjuar dëshmitarët eventual për të vërtetuar faktin e posedimit të pretenduar, në fakt deklaratimet e dëshmitarëve janë të përgjithësuara dhe jo të plota etj.

Tani për tani, kjo gjykatë nuk mund ta pranojë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, si të drejtë dhe të ligjshëm edhe për arsye se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes është dashur që ti vlerësoi edhe dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (LMTHJP), i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik në mes palëve (siç pretendohet nga pala paditëse), e në veçanti nenin 29 të këtij ligji, i cili e ndalon fitimin e të drejtës së pronësisë në pronën shoqërore me parashkrim fitues, duke vlerësuar pastaj se a janë plotësuar kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi ndonjë bazë tjetër ligjore, pasi që parcela kontestuese evidentohet në emër të të paditurës ndërsa në këtë drejtim edhe përkundër faktit se janë administruar disa prova materiale, për gjykatën e shkallës së dytë ka mbetur i pa provuar fakti i mirëbesimit dhe i ligjshmërisë së paditësit në shfrytëzimin e paluajtshmerisë së të paditurës. Mbi bazën e kësaj gjendje, rezulton se fakti i mirëbesimit të paditësve në këtë rast, nuk është provuar. Kjo gjykatë ka parasysh faktin se mirëbesimi paraqet një gjendje përmes të cilës ai në vetvete supozohet se ekziston deri sa nuk provohet e kundërta, mirëpo duke pasur parasysh faktin se kemi të bëjmë me pronën shoqërore, pronë kjo specifike e cila gëzon një mbrojtje dhe status specifike në të drejtën tonë pozitive, gjykata e shkallës së parë është dashur që çështjen e mirëbesimit ta sqarojë në tërësi dhe pa asnjë mëdyshje, gjithmonë në kuptim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë procedurë në pajtim me provat e të dy palëve e jo duke ua falur besimin vetëm pretendimeve të palës paditëse dhe konstatimit të ekspertit gjeodet, në anën tjetër fare nuk merren për bazë e as nuk jepet arsyetim se përse gjykata e shkallës së parë nuk ua ka falë besimin pretendimeve dhe kundërshtimeve të paditurës.

Si shkak i vërtetimit jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka ardhur edhe deri të zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, për të cilën gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare, me çka mbi bazën e shkeljeve të konstatuara aktgjykimi i atakuar u dashtë që te prishet dhe të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, pastaj së bashku me palët apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertin gjeodet të dal përsëri në vend, ashtu që gjykata sipas përshkrimit të cilin do ta bëjnë paditësit rreth paluajtshmerisë që pretendojnë të drejtën e pronësisë, të udhëzojë ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtshmerisë kontestuese. Pas identifikimit dhe matjes se saktë e cila do të bëhet nga eksperti gjeodet, gjykata do duhet ta bëjë përshkrimin e gjendjes faktike në vend dhe pastaj sipas mendimit-raportit me shkrim të cilin eksperti gjeodet do duhej t'ia sigurojë gjykatës, gjykata e shkallës së parë nuk do duhej të kishte pengesa që padinë e paraqitur nga ana e paditësve t'ia kthej në rregullim, duke i ftuar paditësit që kërkesëpadinë lidhur me parcelën kadastrale - apo pjesën e saj, në të cilën pretendojnë se kanë të drejtën e pronësisë ta harmonizojnë me të gjeturat e bëra nga eksperti gjeodet dhe gjykata me rastin e daljes në vendshikim. Pastaj varësisht prej rregullimit apo mos rregullimit të padisë nga ana e paditësve, gjykata të ndërmerr hapat tjerë

procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plot dhe të drejtë të gjendjes faktike, nga Zyra Komunale Kadastrale në R....., të kërkohet historiat i pronës për parcelën kontestuese, duke mos përjashtuar mundësinë e kërkimit të të dhënave edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, të bëhet dëgjimi i dëshmitarëve e në rast nevojë edhe ballafaqimi i tyre, dëgjimi i palëve ndërgjyqëse në cilësi të palës dhe provave të propozuara nga palët, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësve dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si me lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata po ashtu në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 paragraf 1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2380/2021, me datë 25.03.2024

Kryetari i kolegjit
Naim Mehulli, d.v